CEE bankwatch network

Lumenjtë e thyer

Ndikimet e hidrocentraleve të vegjël të financuara nga Evropa në peizazhet e pacënuara të Ballkanit

Dhjetor 2017

Mirënjohje
Klara Sikorova, Bankwatch
Petr Hlobil, Bankwatch
Olsi Nika, EcoAlbania
Elton Qendro
Agim Blloshmi, Shoqata Egnatia
Ediola Terziu, Shoqata Egnatia
Spase Shumka
Fatmir Brazhda
Danjel Bica, Shoqata Ekspertet e Rinj Mjedisor

Fotografitë
Bujar Karoshi, Petr Hlobil, Klara Sikorova, Igor Vejnovic, Pippa Gallop, Andrey Ralev, Dimiter Koumanov

Redaktimi
Pippa Gallop

Ky publikim është pjesë e fushatës "Të Shpëtojmë Zemrën Blu të Evropës" zbatuar nga EurNatur Fondacioni i Trashëgimisë Natyrore Europiane (www.euronatur.org) dhe Rivewatch – Shoqata për Mbrojtjen e Lumenjve. (www.riverwatch.eu/en/). Mbështetur nga Fondacioni MAVA

Ky publikim është bërë i mundur me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është nën përgjegjësinë e vetme të CEE Bankwatch Network dhe nuk mundet në asnjë rrethanë të konsiderohet se paraqet qëndrimin e Bashkimit Evropian.

Foto: vepra e marrjes e Tearcë 97 (Bistrica 97) hidrocentral në brendësi të malit të Sharrit, e përcaktuar si zonë Emerald (© Andrey Ralev)

Përmbledhje

Përmbledhje ekzekutive 4

Shqipëria 7

Përmbledhje ekzekutive

Rajoni i Ballkanit është një strehë lumenjsh e liqenesh të pastra e të egra. Por gjatë pesëmbëdhjetë viteve të fundit ka qenë nën presionin e vazhdueshëm të planeve të ndërtimit të mijëra hidrocentraleve.[1] Teksa pjesa më e madhe e planeve ende nuk janë realizuar, shumica e hidrocentraleve të ndërtuara janë mbështetur nga paratë publike Evropiane, nëpërmjet bankave si Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Banka Europiane e Investimeve që kryeson.[2] Qindra miliona euro të parave publike janë hedhur në infrastrukturën e hidrocentraleve në rajon. Bankat i paraqesin këto hidrocentrale si energji e gjelbër, kur në fakt 24 projekte të mbështetura ndërmjet viteve 2005-2015 nga bankat të zhvillimit multilateral rezultuan të jenë brenda, në kufijtë e, ose me ndikim të drejtpërdrejtë në zonat e mbrojtura.[3]

Teksa ndërtimi i hidrocentraleve të mëdha shihet si tejet i vështirë, ato të voglat me tarifat e tyre tërheqëse janë ndërtuar në numër të madh, veçanërisht në Shqipëri. Ky duket të jetë një trend që po vijon, megjithëse kontributi i tyre në prodhimin e përgjithshëm të energjisë elektrike është i vogël krahasuar me sasinë e dëmit që shkaktojnë. Ndërmjet viteve 2001 dhe 2015, 57 hidrocentrale të mëdha kontribuan 97% të prodhimit të energjisë hidrike në Ballkanin Perëndimor, kundrejt 387 hidrocentraleve të vegjël që kontribuan me vetëm 3%.[4]

Për të parë ndikimet e këtyre projekteve në praktikë, në vitin 2017 Bankwatch ka ndërmarrë vizita në 8 projekte hidroenergjetike të financuara nga BE në Shqipëri (2) Kroaci (1) dhe Maqedoni (5). Në total kemi vizituar 12 pika të devijimit në veprat e marrjes dhe një HEC me rrjedhje në shtratin e lumit, të gjitha të ndodhura në zona të mbrojtura ose në zona ekologjikisht të ndjeshme. Në tri raste (Tresonecka reka, Tearcë 97-98, Rapuni 1-2), impiantet ndodhen në zonat Emerald, që do të thotë se ato janë zona të ardhshme të rrjetit Natura 2000, ndërsa Ilovac në Kroaci, në lumin Kupa, ndodhet në zonën Natura 2000.[5]

Vetëm hidrocentrali Ilovac në Kroaci ka kaluar përmes një procedure të plotë VNM dhe të ashtuquajturit Vlerësim të posaçëm të ndikimeve në biodiversitet të përcaktuara në nenin 6.4 të Direktivës së Habitateve, të BE-së. Megjithatë, edhe ky rast tregon se të qenit në BE nuk garanton një vlerësim të shëndoshë mjedisor. Në përgjithësi konkluduam se të gjitha hidrocentralet e vizituara kanë nevojë urgjente për rritjen e monitorimit të ndikimit, si dhe masave restauruese. Në shumicën e rasteve janë të dukshme shkelje flagrante të ligjeve kombëtare dhe standardeve të institucioneve financiare ndërkombëtare.

Vitet e fundit, bankat i kanë përmirësuar politikat e tyre të huadhënies. Në vitin 2016 Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim miratoi udhëzimet mbi huatë për hidrocentralet.[6] Gjithashtu, Politika Mjedisore

dhe Sociale e saj, e vitit 2014 përmban një përkufizim të gjerë të Zonave të Mbrojtura, që përfshin disa zona që nuk kanë titull kombëtar si të tilla dhe pranon edhe rëndësinë e zonave të mbrojtura të planifikuara për t'u shpallur, jo vetëm ato ekzistueset. Banka Evropiane e Investimeve aktualisht po krijon udhëzimet mbi huatë për hidrocentralet që duhet të përmirësojë shqyrtimin e huadhënies sektoriale.

Megjithatë, rastet e mësipërme tregojnë për urgjencën e nevojës së shtrëngimit të mëtejshëm të politikave. Ata nxjerrin në pah tre të meta të mëdha në politikat e huadhënies të bankave.

Së pari, bankat supozojnë se studimet mjedisore të zellshme gjithmonë do të pengojnë ndërtimin e projekteve të hidrocentraleve me efekte tejet dëmtuese dhe se më tej ata do të krijojnë masa zbutëse efektive.

Kjo është shumë larg të vërtetës në Ballkan. Shumica e projekteve të hidrocentraleve janë paraqitur si të vogla, edhe pse mund të përfshijnë ndikime dhe sipërfaqe të konsiderueshme dhe nuk kalojnë nëpër një procedurë tërësore vlerësimi të ndikimit në mjedis. Për shkak të kapacitetit të ulët elektrik ata kategorizohen automatikisht si "me ndikim të ulët". Edhe kur ndërtimi është kryer, procesi i vlerësimit të ndikimit në mjedis kryhet shumë rrallë sipas standardeve të parashikuara në Direktivën e VNM të Bashkimit Europian dhe vlerësimi i ndikimeve kumulative është pothuajse joekzistent.[7] Megjithatë, siç tregon edhe ky raport, të ashtuquajturat projekte të vogla të hidro-energjisë, në fakt mund të kenë ndikim të konsiderueshëm.

Së dyti, bankat, afërmendsh, po krijojnë marrëdhënie me klientët bazuar në vullnetin e mirë, duke prezumuar se ata do të veprojnë në përputhje me legjislacionin e brendshëm dhe standardet e bankave në vend që t'i shkelin ato. Por, për kompanitë që operojnë në një kontekst rregullator kaq të dobët, ekziston një nxitje për të thyer rregullat, në emër të maksimizimit të gjenerimit të elektricitetit dhe rritjes së përfitimeve. Për shembull, në Shqipëri, klienti e ka tejkaluar hapësirën që i jep rregulli duke devijuar ujin në një drejtim të një tjetër HEC-i, gjë që çoi në tharjen e 4.3 km të shtratit të lumit, edhe pse kjo nuk ishte në projektin e miratuar nga Banka.

E treta është se qeverisja në shtetet përkatëse është mjaftueshëm e fortë për të evidentuar dhe sanksionuar shkeljet e legjslacionit të brendshëm, në rast se klientët e bankave shkelin rregullat. Sa i përket çështjeve të përmendura këtu, përgjithësisht nuk jemi përpara këtij rasti. Rrugë-migrime të posaçme të peshkut të bllokuara, prerja ilegale e pyjeve dhe rrjedha të mbetura të pakta ose krejt të mbyllura nuk janë adresuar në mënyrën e duhur nga "autoritetet kombëtare kompetente".

Kjo situatë kërkon veprim të menjëhershëm: Bankat duhet të ndalojnë në mënyrë të prerë financimin e çdo investimi hidro-energjetik në zonat e mbrojtura në Ballkan, në linjë me lëvizjen IUCN 26,[8] pavarësisht nëse ato janë ekzistuese ose të planifikuara. Investimet hidro-energjetike duhet gjithashtu të shmangen në Habitatet Kritike,[9] pavarësisht nga statusi i tyre ligjor.

Për shkak të ekzistencës së shumë faktorëve që mbeten jashtë kontrollit të bankave, të gjitha hidrocentralet në zonat e mbrojtura dhe habitatet e rrezikuara duhet të përfshihen në listat e tyre të përjashtimit.[10] Duke pasur parasysh raportin elektricitet i pakët: ndikim në mjedis, bankat duhet të vlerësojnë nëse projektet e hidrocentraleve të vegjël në rrjedhat ujore të ruajtura mirë ia vlejnë ose jo të ndërtohen.

Në rast se projekte të tilla, gjithësesi konsiderohen, bankat duhet të shmangin dëmtimin joproporcional të mjedisit duke siguruar që hidrocentralet të jenë pjesë e strategjive aktuale të menaxhimit të energjisë dhe të pellgjeve lumore dhe duke siguruar që vlerësimi mjedisor të kryhet tërësisht edhe për projekte të vogla. Komisioni Evropian duhet gjithashtu të luajë një rol më të madh duke ndihmuar vendet të miratojnë dhe zbatojnë Direktivën Kuadër të BE-së për Ujin si dhe Direktivat për Shpendët dhe Habitatet me qëllim të përmirësimit të menaxhimit strategjik të lumenjve në rajon dhe të ndihmojë shtetet të shmangin presionin e tepërt në lumenj.

Figura 1: Përmbledhje e hidrocentraleve të vizituara

Hidrocentrali	Vendi	Kompania	Origjina e investitorit	Banka	Rekomandimi
Rapuni 1-2	Shqipëri	C & S Construction Energy shpk	Shqipëri	EBRD	Rikthimi i menjëhershëm i rrjedhës natyrore, restaurimi i brigjeve të lumenjve, kompensimi i komuniteteve të prekura
Tërnovë	Shqipëri	Teodori 2003 shpk	Shqipëri/Kanada	EBRD	Masa urgjente të restaurimit (rivegjetimi, kurthet e sedimenteve), rinegocimii përdorimit të ujit me komunitetet lokale
Ilovac	Kroaci	Tekonet d.o.o.	Kroaci	EIB	Publikimi i raporteve të monitorimit; hulumtimi shtesë i biodiversitetit; shmangia e ndërtimit të hidrocentraleve të tjera në Kupa
Brajcinska reka 1	Maqedoni	Mali hidroelektrani DOO	Maqedoni	EBRD	Rivendosja urgjente e rrjedhës natyrore
Brajcinska reka 2	Maqedoni	PCC HYDRO DOOEL	Gjermani	EBRD/ KfW	Mbikëqyrja e afërt e ndikimeve në llojet endemike, p.sh. Trofta e Prespës
Tresonecka reka	Maqedoni	Hidro Enerdzi Group	Maqedoni	EBRD	Rivendosja urgjente e rrjedhës natyrore
Lipkovo	Maqedoni	SOL Hidropauer DOOEL	Itali	EIB	Zhbllokimi i kalimit të peshkut, pastrimi i pellgut, restaurimi i vegjetacionit
Tearce 97-99	Maqedoni	SOL Hidropauer DOOEL	Itali	EIB	Restaurimi i rrjedhës së mjedisit, rehabilitimi i pyjeve dhe shtratit të lumit

Foto 2: Vendodhjet e hidrocentraleve të vizituara



Shqipëria

Shqipëria e prodhon të gjithë energjinë elektrike të saj nga hidrocentralet.[11] Që nga qershori 2017, 177 hidrocentrale janë në punë e janë licensuar nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE); 43 hidrocentrale janë në ndërtim e sipër dhe 364 të tjerë janë planifikuar nga Ministria e Energjisë.[12]

Projektet e hidrocentraleve po ushtrojnë presion të madh në mjedis. Shqipëria ka ende zona natyrore të pacënuara në krahasim me BE-në, ku gjenden rreth 30% të specieve të florës evropiane dhe 42% të gjitarëve në Evropë.[13] Megjithatë, vetëm 16% e territorit të saj mbulohet nga Zonat e Mbrojtura dhe deri më tani sistemi i brishtë i qeverisjes nuk ka qenë në gjendje të balancojë rreziqet e zhvillimit me mbrojtjen e mjedisit. Në vitin 2017, një Ligj i ri për Zonat e Mbrojtura më në fund ndalon ndërtimin e hidrocentraleve në Parqet Kombëtare,[14] por kjo lëvizje, vjen shumë vonë për hidrocentralet si ai i Rapuni-t, që do të trajtohet më poshtë. Janë gjithashtu problematike edhe rastet si ai i hidrocentraleve të planifikuara në lumin Vjosë, ku zona nuk është e mbrojtur ligjërisht.

Projektet e hidrocentraleve të vegjël shpesh nuk kalojnë përmes një Vlerësimi gjithëpërfshirës të Ndikimit në Mjedis (VNM), të cilat në kontekstin e një qeverisjeje të brishtë çojnë në shkatërrim të plotë të mjedisit. Zbatimi i Konventës së Aarhusit është rritur me Ligjin për të Drejtën e Informimit të vitit 2014 dhe Ligjin për Njoftimin dhe Konsultimin Publik të vitit 2014. Por ende nevojiten përmirësime të rëndësishme: në një vendim të gjykatës së fundmi thuhet se konsultimet publike për një hidrocentral ishin plotësisht të sajuara.[15] Zbatimi, të paktën në terma afatshkurtër, ishte dobësuar për shkak të decentralizimit të vitit 2015, ku disa kompetenca të institucioneve qendrore iu kaluan qeverisjes lokale. Kjo ka shkaktuar boshllëqe në zbatimin e legjislacionit mjedisor, si p.sh.: menaxhimi i pyjeve, më parë i kryer nga Inspektorati i Pyjeve, tani është transferuar tek bashkitë. Është, për pasojë detyrë e bashkive të raportojnë për shkeljet e Ligjit për Pyjet, të cilave u mungojnë kapacitetet për ta ushtruar në mënyrën e duhur këtë detyrë.

Gjetjet kryesore: Ekziston një mungesë pothuajse e plotë e monitorimit dhe zbatimit nga ana e autoriteteve shqiptare. Në të dy projektet që kemi vizituar, shkatërrimi mjedisor pasonte edhe efekte sociale, duke qenë se lumenjtë përdoreshin edhe për ujitje. Rrjedhat minimale ekologjike nuk respektohen. Infrastruktura ndihmëse, siç janë rrugët hyrëse, sjell shkatërrime të mëtejshme të mjediseve të pacënuara.

Rekomandime

- BERZH dhe institucionet e tjera ndërkombëtare duhet të ndalojnë marrjen në konsideratë të çdo investimi në skemat hidroenergjetike (siç është ajo e hidrocentralit të Skavicës) para se të investojnë në aspektin rregullator (p.sh. asistenca teknike për ngritjen e kapaciteteve lidhur me lejet mjedisore dhe monitorimin si dhe masat kundër korrupsionit) gjë e cila do të ndikonte kontrollin e lejeve, si dhe të monitorimit.
- Për hidrocentralet ekzistuese, BERZH dhe institucionet e tjera ndërkombëtare duhet të sigurojnë komunikim më të mirë me komunitetet lokale për t'u dhënë mundësi banorëve të shprehin ankesat e tyre.
- Çdo planifikim strategjik duhet të krijojë "zona të ndaluara" (të paktën në Zonat e Mbrojtura të kategorive I-VI, sipas IUCN,[16] si dhe zona të njohura ndërkombëtarisht, siç janë Zonat e Rëndësishme për Bimët).
- Gjatë shqyrtimit të politikës së saj mjedisore dhe sociale, BERZH duhet të rishqyrtojë qasjen e saj ndaj projekteve të Kategorisë B, duke rritur nivelin e publikimit të informacionit, si dhe shqyrtimin mjedisor dhe social.
- BERZH së bashku me Komisionin Evropian mund të luajë rol të madh nëpërmjet ndihmesës së shteteve në miratimin dhe zbatimin e Direktivës Kuadër të Ujërave, të BE-së dhe Direktivat e Shpendëve dhe Habitateve dhe duhet të marrin në konsideratë ndërprerjen e investimeve në projekte të reja të hidro-energjisë derisa të zbatohen Direktivat për mbrojtjen e natyrës.

Rapuni 1 & 2

Hidrocentralet Rapuni 1 & 2 ndodhen në lumin Qarrishtë[17] që rrjedh tërësisht përmes Parkut Kombëtar të Shebenik-Jabllanicës. Zona është nën presion ekstrem nga zhvillimi i hidrocentraleve: 45 koncesione për hidrocentrale janë dhënë brenda kufijve të Parkut Kombëtar.[18]

Rapuni 1 dhe 2 janë ndërtuar si një kaskadë, duke filluar me veprën e marrjes të "Rapuni 1", e ndjekur nga centrali i prodhimit "Rapuni 1" dhe vepra e marrjes e "Rapuni 2", të cilat janë bashkuar dhe përfundojnë me centralin e prodhimi të "Rapunit 2" pranë bashkimit me lumin e Rapunit. Megjithatë, ndikimi i projektit nuk mbaron aty - një tunel betoni dërgon të gjithë ujin e rrjedhës nga centrali i prodhimit "Rapuni 2" në një tjetër HEC – "Rapuni 3 & 4". Së bashku këta HEC-e thajnë tërësisht këtë pjesë të shtratit të lumit deri në Librazhd.

Drafti i planit të menaxhimit të Parkut Kombëtar identifikon hidrocentralet si kërcënimin kryesor për burimet ujore.[19] I njëjti dokument thekson se brenda Parkut janë regjistruar 14 lloje peshqish në lumenjtë Shkumbin, Rapun, Qarrishtë dhe Bushtricë, duke përfshirë pesë specie që janë në Listën e Kuqe të IUCN: Anguilla anguilla (tejet e rrezikuar), Oxynoemacheilus pindus (Vulnerable) Barbus meridionalis dhe Rutilus rubilio (të dyja pranë kërcënimit), dhe Salmo trutta macrostigma (i pavlerësuar).[20]

- *Themelues & operator: C & S Construction Energy sh.p.k.*
- *Në funksion që prej : 2013*
- *Vepra e marrjes Rapuni 1 41.239118, 20.362062 centrali Rapuni 1 41.239904, 20.320364*
- *Vepra e marrjes Rapuni 2 41.239904, 20.320364 centrali Rapuni 2 41.219477, 20.303962*
- *Kapaciteti i instaluar: Rapuni 1: 4.46 MW Rapuni 2: 3.78 MW*
- *Financues: BERZH kredi 7 200 000 EUR në 2011*
- *Zonat e mbrojtura: Shebenik-Jabllanicë National Park, Propozuar si zonë Emerald*

E rëndësishme: Rrjedhja e ujit të mbetur është jo e përshtatshme dhe nuk është përcaktuar paraprakisht; kalimet e peshkut janë problematike. Dhe së fundi, ndikimet kumulative janë katastrofike: Kalimi i ujit të ardhur nga Rapuni 2 nëpër një tunel në Rapuni 3 & 4 lë pothuajse aspak ujë për stacionin e prodhimit Rapuni 2, gjë e cila ka çuar në tharjen e shtratit të lumit në gjatësi prej 4.3 km.



Figura 3: Harta e Hidrocentraleve të Rapunit

Bankwatch vizitoi nga afër hidrocentralet në Qershor të vitit 2017.[21] Ekipi, ku u bashkuan edhe hidro-biologë, vizitoi të gjitha centralet e prodhimit dhe veprat e marrjes në kaskadë dhe zhvilloi intervista me komunitetet e prekura. Pasi botuam rezultatet tona fillestare,[22] BERZH dërgoi një mision vëzhgimi, duke konfirmuar disa nga vërejtjet tona.[23]

Edhe pse e ndërtuar në një zonë të ndjeshme dhe me biodiversitetit të lartë, asnjë Procedurë e plotë e vlerësimit të ndikimit në mjedis nuk është kryer për këtë projekt. Thuhet se një "Raport Përmbledhës i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis" iu dorëzua Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për miratim. Një Plan i detajuar i Menaxhimit të Mjedisit si dhe Plani i masave zbutëse te ndikimeve në mjedis thuhet, përsëri, të jetë përgatitur dhe dorëzuar me Raportin e VNM-së. Leja mjedisore nr.440 është lëshuar më 9 qershor 2008.[24] Megjithatë, një kërkesë për informacion dërguar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit të Shqipërisë rezultoi në përgjigjen se raporti Përmbledhës nuk është i disponueshëm.[25] Në përgjigje të një kërkese drejtuar BERZH-it, banka deklaroi se projekti i Rapunit ishte kategorizuar B dhe kësisoj nuk ishte subjekt i Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe social sipas kërkesave të BERZH-it.[26]

Në vijim të vizitës në terren, gjatë sezonit të thatë në Qershor 2017, vlerësimi ynë vizual ishte se errjedha minimale ekologjike në lumin Qarrishtë ishte mesatarisht 0.05-0.1 m3/s (50-100l/s), që është 2% e mesatares vjetore të prurjeve të lumit, prej 5,95 m^3/s.[27] Organizatat lokale raportojnë se në vitet e fundit, lumi madje është tharë tërësisht.[28] Është me rëndësi të madhe që kapaciteti i instaluar të përcaktohet sipas kthimit të investimeve dhe jo vlerësimit ekologjik dhe hidrologjik.[29] Pas misionit vëzhgues të Korrikut 2017, BERZH konfirmoi se prurja e mbetur është e papërshtatshme dhe vlerësohet se duhet të jetë së paku 0.3 m3/s, por nuk ofroi përllogaritjet mbi të cilat përcaktohet një prurje e tillë.[30] Një kërkesë nga BERZH për të rivendosur rrjedhën e përshtatshme ekologjike hyri në fuqi menjëherë pas vizitës së

Foto 4. Rrugë-kalimi i peshkut në strukturën hyrëse "Rapuni 1"

Foto 5 rrugë-kalimi i peshkut në strukturën hyrëse "Rapuni 2"

saj monitoruese.[31]

Strukturës së rrugë-kalimit të peshqve, ndërtuar në marrjen e "Rapuni 2" i mungon uji dhe ka një hyrje pothuajse të tharë në drejtim të rrymës dhe një portë uji në dalje në rrjedhën e sipërme në një pozicion gjysmë të poshtëm. Gjithashtu, në kohën e vizitës është vënë re se një rrjedhë më e pështatshme në krahasim me ujërat e lëshuara nga rrugë-kalimi i peshqve shkarkohej në lumë pak më poshtë. Rrugë-kalimi i peshqve në "Rapuni 1" është projektuar më mirë dhe ka më shumë ujë. Por duke pasur parasysh regjimin e jofunksional të rrjedhës ekologjike, kalimet e peshkut janë të padobishme dhe do të kishin efekt vetëm nëse do të kishte më shumë ujë nën pikën e hyrjes.

Rrugët hyrëse dhe punimet e tjera ndërtimore në bregun e majtë të lumit kanë shkaktuar erozion. Kompania është përpjekur të rehabilitojë pjesërisht bimësinë bregore të shkatërruar nga punimet e ndërtimit dhe mungesa e ujit, por e ka bërë këtë duke mbjellë akacie (Robinia pseudoacacia) që është një specie invazive në kontekstin e ekosistemit vendas të Parkut Kombëtar. Ekipi i BERZH-it konfirmoi erozionin dhe urdhëroi "një vlerësim nga inxhinierë të përshtatshëm të kualifikuar ... për të shqyrtuar stabilitetin e strukturave të transferimit të ujit dhe çdo përmirësim që mund të kërkohet".[32]

Ndikimet kumulative dhe konfliktet rreth të drejtave të përdorimit të ujit

Kompania "C & S Construction Energy" ka bërë përpjekje për të komunikuar me komunitetet pranë. Sipas punëtorëve të intervistuar në vend, kompania ka ndërtuar dhe mbajtur një rrugë rurale 3 km në zonë. Po ashtu kompania ka bërë përpjekje për të riparuar kanalet e ujitjes pranë centralit të prodhimit të "Rapuni 2" dhe për të financuar programe për grupet e pambrojtura sociale.

Megjithatë, në të njëjtën kohë, kompania ka negociuar një marrëveshje për ndarjen e ujit me operatorin e hidrocentralit afër "Rapuni 3 & 4". "C & S Energy", kompania projektuese e "Rapuni 3 & 4," është kryesisht në pronësi të Kishës Ortodokse Shqiptare, por në masën 2% edhe në pronësi të "C&S Construction",[33] e njëjta kompani që zotëron HEC-et "Rapuni 1 & 2". Në fillimet e saj, "C & S Energy", ishte në fakt me shumicën e aksioneve të kontrolluar nga kompanitë "C & S Construction" dhe "Ferar sh.p.k" në pronësi të Arjan dhe Ferid Cukaj.[34]

I gjithë uji i lëshuar nga centrali i prodhimit të "Rapuni 2" drejt skemës "Rapuni 3 & 4".

Kombinuar me faktin se diga "Rapuni 3 & 4" nuk ka rrugë-kalim peshqish dhe nuk lë asnjë rrjedhë ekologjike,[35] kjo krijon impakte serioze mjedisore dhe sociale në shtrirjen 4.3 km deri në bashkimin e Rapunit me Shkumbin in. E vetmja rrjedhë që mbetet është prurja e mbetur që është dërguar në hyrjet e "Rapunit 1 dhe 2", siç është vërejtur tashmë, jo e mjaftueshme për Qarrishtën, e për të mos përmendur lumin kryesor, Rapuni-n.

Vizita në terren ka dokumentuar të paktën tre konflikte të komunitetit me të drejtat mbi ujin, të cilat janë pasojë e mungesës së ujit në lumin Rapun: një mulli misri në pronësi të familjes Shkurti afër bashkimit të Qarrishtës me Rapuni-n, një fshat i vogël me 5 shtëpi afër digës së "Rapuni 3" dhe fshati Togëz që është më shumë në drejtim të rrymës, duke ndikuar në total në qindra familje.[36] Vetëm rasti i parë lidhet drejtpërdrejt me lidhjen e "Rapunit 2" me "Rapuni 3&4". BERZH ka pranuar problemin dhe ka rekomanduar lirimin e menjëhershëm të më shumë uji, në mënyrë që mulliri të mund të rifillojë punën, si dhe kompensimin e pronarit, pa specifikuar procesin ose shumën. Që nga 15 nëntori 2017, asnjë prej të dy rekomandimeve nuk janë përmbushur.[37]

Vlen të theksohet se projekti "Rapuni 3&4", i cili vepron në mënyrë të paligjshme duke mos lëshuar rrjedhën e ekologjike në shtratin e lumit, ndonëse nuk financohet nga BERZH, financohet nga Banka Kombëtare e Greqisë (NBG),[38] bankë në pronësi të Fondit të Stabilitetit Financiar Helenik. Përveç shkeljes së standardeve të prurjeve ekologjike, projekti ka dëmtuar shtëpitë në fshatin Togëz dhe nuk i ka kompensuar banorët.[39] Ky hidrocentral është gjithashtu në kufirin e rezervatit natyror Kuturman, një zonë kandidate Emerald.

Çfarë shkoi keq

Monitorimi i BERZH i kryer në vitet e mëparshme nuk e ka identifikuar problemin me mullirin e miellit të misrit. Ai identifikoi çështjet me rrugë-kalimin e peshqve.[40] Gjithashtu, nuk është e qartë nëse Banka ka vënë re tunelin midis "Rapuni 2" dhe "Rapuni 3&4". Por është e sigurtë që një lidhje e tillë nuk ishte pjesë e projektit origjinal të financuar nga BERZH.[41]

Foto 6: Tuneli që merr ujë në pjesën e poshtme të "Rapuni 3&4"

Foto 7: Diga "Rapuni 3&4" nuk lë rrjedhje ekologjike

Fakti që BERZH nuk kërkoi një VNM sipas standardeve të BERZH - megjithëse projekti është në një Park Kombëtar - është gjithashtu shqetësues dhe mund të ketë çuar në disa nga çështjet siç janë rrjedha e mbetur pamjaftueshme. Prandaj, nuk ekziston as vlerësimi i ndikimeve kumulative me "Rapuni 3&4", edhe pse në kohën e dhënies së kredisë (2011) koncensioni për "Rapuni 3&4" tashmë ishte nënshkruar.[42]

Ky shembull tregon se si operimi në një kontekst të dobët rregullator mund ta ekspozojë bankën ndaj rrezikimit të reputacionit. Edhe nëse Banka nuk ka kontroll mbi çështjen nëse të dy projektet do të lidhen, nuk mund të injorojë faktin se klienti i saj ka ndryshuar dukshëm planin e projektit dhe si përfundim ka financuar de facto pjesë të së njëjtës skemë që vepron në mënyrë të paligjshme dhe jashtëzakonisht të dëmshme për mjedisin dhe komunitetet lokale.

Rekomandime

- Të sigurohet menjëherë rrjedha ekologjike sipas parashikimeve prej 300 l/s. Të kryhen kërkime për të përcaktuar sasinë e përshtatshme të rrjedhës që do të jetë e mjaftueshme për të mbështetur të gjitha funksionet ekologjike.[43]
- Kompensimi i mullisit për humbjet e deritanishme.
- Krijimi i një lidhjeje me Drejtorinë Rajonale për Zonat e Mbrojtura për të koordinuar masat zbutëse dhe restauruese në një mënyrë që të mos dëmtohet integriteti ekologjik i Parkut Kombëtar (p.sh. mos përdorimi i specieve invazive për masat e restaurimit).
- Të porositet një studim për funksionalitetin e rrugë-kalimeve të peshqve në veprat e marrjes së HEC-eve "Rapuni 1 dhe 2" dhe të merren masa për përmirësimin e tyre.
- VNM duhet të jetë i detyrueshëm edhe për projekte më të vogla, veçanërisht në zonat me biodiversitet të lartë dhe në Zonat e Mbrojtura.

Tërnovë

Projekti HEC Tërnovë është zhvilluar si një ndërmarrje e përbashkët midis kapitalit kanadez dhe atij shqiptar. Kompanitë pretendojnë se po zbatojnë praktika të mira ekologjike.[43]

- *Themelues & operator: Teodori 2003 sh.p.k.*
- *Në funksion që prej: 2016*
- *Marrja: 41.457373, 20.302736*
- *Centrali i prodhimit: 41.496254, 20.316749*
- *Kapaciteti i instaluar: 8.385 MW*
- *Huaja: nga BERZH 6 000 000 EUR në vitin 2012*
- *Zonat e mbrojtura: Liqeni i Zi (Martanesh) Monument Natyre*

Projekti po shkakton erozion serioz dhe shpyllëzim. Gjithashtu rrezikon një liqen akullnajor, i përcaktuar si një monument natyror kombëtar. Po ashtu nuk u konsultua në mënyrë adekuate me komunitetin lokal, i cili fajëson kompaninë për mungesën e ujit për vaditje. Kjo shkaktoi tension dhe konflikte të dhunshme në vitet 2014, 2015 dhe 2016.

Sipas kompanisë që ka realizuar planin e projektit, ky projekt përfshin 23 km kanale të devijimit, duke rritur lartësinë e disa digave ekzistuese deri në 10 m, rindërtimin e digave me një lartësi prej 40 m, ndërtimin e 3 tuneleve hidraulike, 5 km me tub (konstruksion) me diametër deri në 700 mm dhe lartësi maksimale 1000 m, rreth 30 km rrugë hyrëse, rreth 10 km linjë furnizimi me energji elektrike dhe punime të tjera të përkohshme.[44] Ky është një projekt i madh infrastrukturor, por nuk i është nënshtruar VNM-së së plotë sipas procesit të miratuar të BERZH-it.[45]

Projekti ndryshon nga skemat e zakonshme të devijimit: në vend që të devijojë ujin nga një lumë, Hidrocentrali i Tërnovës tërheq ujin nga një sistem liqenesh në majën e malit Maja e Gjatë, mal pranë Bulqizës, Qarkut Dibër. Vepra e marrjes ndodhet në Liqenin e Zi (akullnajor), i cili mbrohet si Monument Natyre.[46] Për të rritur kapacitetin e liqenit, në Liqenin e Zi uji merret nga të paktën dhe një liqen tjetër natyror- Liqeni i Bardhë (i njohur gjithashtu si Liqeni i Bardhë i Tërnovës). Për aq sa jemi në dijeni, aktualisht po sillet apo planifikohet që të ndërtohet një tjetër kanal devijimi që do të devijonte drejt Liqenit të Zi edhe ujërat nga Liqeni i Bardhë (Liqeni i Bardhë i Valikardhës) dhe Liqeni i Sopës.[47] Tubi përshkon një rrugë prej 5 km deri në centralin e prodhimit, duke shfrytëzuar energjinë e lartësisë më një rënie prej gati një kilometër.

Foto 8: Tabelë për monumentin natyror Liqeni i Zi (Foto: Bujar Karoshi)

Liqeni i Zi është përdorur më parë për vaditje. Për shkak se komunitetet lokale nuk ishin konsultuar siç duhet, projekti krijoi një çarje, ku disa nga fshatarët iu kthyen protestave dhe pretendohet se pati edhe dhunë.[48] Konfliktet e fundit të vërejtura ishin në vitin 2016 rreth liqenit të Sopës, ku kompania dyshohet se filloi punimet pa lejet e duhura.[49] Liqeni i Sopës përdoret gjithashtu për ujitje si dhe për hidrocentralet "Koka 1 dhe 2".

Bankwatch vizitoi nga afër hidrocentralin në Qershor 2017[50] dhe dokumentoi disa çështje në lidhje me performancën mjedisore dhe sociale të operimit të HEC-it. Pasi botuam gjetjet tona,[51] BERZH dërgoi një mision vëzhgimi, duke konfirmuar disa nga konkluzionet e Bankwatch.[52]

Vizita në terren identifikoi çështjet kryesore në lidhje me erozionin dhe shpyllëzimin. I gjithë tubacioni grumbullues kalon mbi tokë dhe është i rrethuar nga kodra të eroduara, kryesisht të përbëra nga toka argjilore. Pjesa qendrore e tubacionit në veçanti ndikohet nga erozioni, në masën që duket se ekziston rreziku i rrëshqitjes së dheut.

Shpyllëzimi ka ardhur si rezultat i punës gërmuese për të krijuar hapësirë për tubacionin. Gjithashtu gërmimet për bazat e tubacionit, rrugët e hyrjes dhe linjat e energjisë elektrike, kanë hequr mbulesën e pemëve dhe vegjetacionit. Kompania u gjobit disa herë për prerjen e pemëve pa leje.[53] Statusi i këtyre shkeljeve nuk është i qartë dhe nuk ka pasur asnjë informacionë nga Zyra e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve, Bulqizë lidhur me statusin e gjobës.[54] Zona është e njohur për pyjet e virgjër të

Foto 9: Gurët e nxjerrë, të hedhur në pyll

Foto 10: Kanali ushqyes duke sjellë sedimente në liqenin e Zi

Foto 11: Harta e projektit, vijat blu që nënkuptojnë kanalet e ushqyesve dhe vija e kuqe të tubit grumbullues

ahut[55] të populluara prej arinjve të murrmë[56] si edhe me lloje të ndryshme të bimëve endemike.[57]

Praktikat e dobëta të ndërtimit vazhdojnë edhe përgjatë veprës së marrjes: poshtë rrugës së hyrjes që të çon nga Liqeni i Zi në Liqenin e Bardhë, gurët e gërmuar mund të shihen lehtësisht të hedhur në shpatet e pjerrët në pyll. E njëjta rrugë ndiqet nga një kanal ushqyes që sjell sedimente nga Liqeni i Bardhë në Liqeni i Zi.

Konsulentët e BERZH-it vizituan zonën në Korrik 2017. Raporti i monitorimit nuk është publik, por BERZH ka ndarë disa nga pikat kryesore me Bankwatch-in. Gjetjet kryesore konfirmuan se kompania duhet të ripyllëzojë dhe rehabilitojë zonën, duke përfshirë edhe zonën rreth Fushës së Zogut ku, duke qenë se ekziston rreziku i hyrjes së sedimenteve, duhet të ndërtohen strukturat e kurtheve të sedimenteve. Afati përfundimtar i kompanisë për të ripyllëzuar zonën është deri në fund të vitit 2018 dhe për të ndërtuar kurthet e sedimenteve deri në fund të vitit 2017.[58]

Hidrocentrali "Tërnovë" është ndërtuar mbi një grup fshatrash që shtrihen në lindje të Bulqizës, të cilat kanë përdorur ujë nga liqeni i Zi për vaditje që nga vitet 1970. Fshati i Strikçanit merr ujë nga Fusha e Zogut, por fshati Valikardhë e merr atë edhe nga rrëketë poshtë liqenit. Kompania e projektit ishte e përfshirë në ndërtimin e rezervuarit të Fushës ë Zogut, qëllimi i së cilës duket të jetë kompensimi për mungesën e ujit për ujitje.[59]

Në vitin 2016 BERZH njoftoi Bankwatch se kishte kryer një hetim në vend, për shqetësimet rreth projektit pas marrjes së një letre nga një qytetar i prekur. Pas hetimit, Banka nuk gjeti asgjë për të mbështetur pretendimet.[60]

Megjithatë, gjatë vizitës sonë në Qershor 2017, fshatarët e intervistuar ende ankoheshin për mungesën e ujit për vaditje. Disa prej tyre na kontaktuan pas vizitave në terren për të përsëritur ankesat e tyre, duke mos qenë në dijeni se BERZH-i kishte dërguar një mision monitorimi.[61] Problemet në lidhje me procesin e vaditjes janë pjesërisht të shkaktuara edhe nga gjendja e dobët e infrastrukturës së ujitjes dhe ka pasur një mosmarrëveshje rreth mirëmbajtjes ndërmjet kompanisë dhe autoritetit bashkiak. Kjo ishte

gjithashtu arsyeja për konfliktin që shpërtheu në vitin 2014 në (ish) komunën Zerqan,[62] si dhe konfliktet e përmendura tashmë me komunitetin në Martanesh në 2015 dhe 2016.

Misioni më i fundit i monitorimit i BERZH-it zbuloi se kompania nuk ka krijuar një mekanizëm për marrjen dhe shqyrtimin e ankesave. Ky është një tjetër tregues i performancës së dobët të "Teodori 2003" në ndërtimin e marrëdhënieve me komunitetin lokal.

Çfarë shkoi keq

BERZH-i e caktoi këtë si një projekt mjedisor dhe social të kategorisë B. Kjo do të thotë se ishte nën një shqyrtim më të vogël rreth ndikimeve të tij të mundshme sesa do të ishte një projekt i kategorisë A. Ky kategorizim është i diskutueshëm nga pikëpamja e kompleksitetit të projektit, si dhe duke konsideruar statusin e Liqenit të Zi si Monument Natyre.

Përveç kësaj, më pak informacion rreth monitorimit është në dispozicion, pasi sipas BERZH-it "Për Politikën e Informimit Publik të BERZH-it, Banka nuk shpalos PVMS-të e plota (Planet e Veprimit Mjedisor dhe Social) për projektet e kategorisë B, meqë këto shpesh përmbajnë informacione tregtare të ndjeshme".[63]

Para fillimit të punimeve, promotori i projektit, "Teodori 2003 sh.p.k." nuk u konsultua me banorët e

Foto 12: Një pjesë e pastruar për rrugën e kalimit dhe shtyllat e energjisë elektrike

Foto 13: Erozioni rreth tubacionit

zonave, pavarësisht faktit se skema e hidrocentralit potencialisht kufizon aksesin e ujit për komunitetin. Hapa të tillë janë në kundërshtim me kërkesat mjedisore dhe sociale të BERZH-it.

Rekomandime

- BERZH duhet të publikojë të gjitha raportet e monitorimit mjedisor dhe social dhe planet e veprimit që lidhen me hidrocentralin e Ternovës, duke përjashtuar informacionin që përbën sekret tregtar, por duke përfshirë informacionin që është relevant për ecurinë mjedisore dhe sociale të projektit.
- BERZH duhet të publikojë të gjitha dokumentet dhe hartat përkatëse të projektit që mund të dëshmojnë publikisht mungesën e lidhjes midis problematikës së ujitjes dhe skemës së hidrocentraleve.
- BERZH duhet të sigurojë që të gjitha detyrimet e ndërmarra nga kompania lidhur me ripyllëzimin dhe respektimin e masave zbutëse që lidhen me hyrjen e sedimenteve në Liqenin e Zi të zbatohen.
- Kompania duhet menjëherë të fillojë një bisedë me bashkësinë lokale për të zbutur tensionet dhe të konsiderojë bashkë-investime në infrastrukturën e ujitjes së bashku me bashkinë.

Referenca

1. http://balkanrivers.net/en/content/studies
2. https://bankwatch.org/publication/financing-for-hydropower-in-protected-areas-in-southeast-europe
3. Studimi i Bankwatch-it për vitin 2015 nxorri numrin total 30. Nga këto, 21 hidrocentrale të planifikuara, duke u ndërtuar ose në veprim në zonat e mbrojtura ekzistuese ose të njohura ndërkombëtarisht si zona të biodiversitetit të lartë u identifikuan si të financuara nga BERZH. Përveç këtyre, ne kemi mësuar përmes komunikimit në vijim me BERZH-in që kreditë për pesë impiantet janë anuluar. Gjithashtu, BERZH na ka informuar se një hidrocentral - Kamenicka Reka - është i vendosur në një zonë me biodiversitet të pasur (300 m nga një zonë Emerald), por jo brenda saj dhe jo duke ndikuar drejtpërdrejt në zonën e mbrojtur.
4. https://www.wbif.eu/content/stream//Sites/website/library/WBEC-REG-ENE-01-170508-BR1-Past-and-Future-Role-of-Hydropower.pdf, p.30
5. Natura 2000 është një rrjet zonash të përzgjedhura për të siguruar mbijetesën afatgjatë të specieve dhe habitateve më të çmuara dhe të rrezikuara të Evropës.
6. http://www.ebrd.com/documents/environment/pdf-guidance-note-hydropower.pdf
7. https://d2ouvy59p0dg6k.cloudfront.net/downloads/hidro_v6_webr.pdf
8. https://portals.iucn.org/congress/motion/026
9. Siç është përcakruar në Politikën Mjedisore e Sociale të 2014 të BERZHhttp://www.ebrd.com/news/publications/policies/environmental-and-social-policy-esp.html
10. Siç është lista e përjashtimit e bankës ProCredit që përfshin “Aktivitetet në zonat e mbrojtura të përcaktuara sipas ligjit kombëtar ose konventave ndërkombëtare, vendet me interes shkencor, habitatet e llojeve të rralla / të rrezikuara dhe pyjet e rinj e të vjetër me rëndësi ekologjike” https://www.procreditbank.bg/uploads/AboutUsImages/exclusion_list_en.pdf
11. Treguesit IEA për vitin 2015 http://www.iea.org/statistics/statisticssearch/report/?year=2015&country=ALBANIA&product=ElectricityandHeat
12. Faqe 3: http://www.ecoalbania.org/wp-content/uploads/2017/05/HPPs_al_final-report_me-kapak.pdf
13. https://www.climatechangepost.com/albania/biodiversity/
14. Neni 16, c
15. http://www.ecoalbania.org/wp-content/uploads/2017/05/Vendimi-i-Gjykates_HEC_Po%C3%A7em.pdf
16. Në vijim të qasjes së Lëvizjes IUCN 26 mbi Zonat e mbrojtura dhe zona të tjera të rëndësishme për biodiversitetin në lidhje me aktivitetet industriale dhe zhvillimet infrastrukturore të dëmshme për mjedisin https://portals.iucn.org/congress/motion/026
17. Në hartat e mëparshme lumi gjendet i shënuar edhe si Rapuni ose Rrapun
18. http://investigim.al/en/45-hidrocentralet-qe-rrezikojne-parkun-kombetar-te-librazhdit/
19. Plani i Menaxhimit të Parkut Kombëtar Shebenik-Jabllanicë 2015-2024 (i papublikuar), fq. 30
20. Ibid., fq. 20
21. Vizita në terren u organizua në bashkëpunim të ngushtë me EcoAlbania dhe Egnatia
22. http://stories.bankwatch.org/going-through-the-mill
23. https://bankwatch.org/blog/campaign-update-ebrd-confirms-negative-impacts-of-albanian-hydropower-plants-on-people-and-the-environment
24. Project Design Document (PDD) Rapuni 1 & 2 Projektet e Vogla të Energjisë Hidroelektrike në Shqipëri, fq. 23, gjendet ne: https://cdm.unfccc.int/Projects/Validation/DB/AJPEKEUWN3GZ9MOINEVTOA7AA3Y2IQ/view.html
25. Korrespondenca me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit të Shqipërisë, 14 Shkurt 2017
26. Korrespondencë me BERZH, 25 Gusht 2017, https://bankwatch.org/wp-content/uploads/2017/09/response-EBRD-RapuniTernoveAL-Aug2017.pdf
27. Project Design Document (PDD) Rapuni 1 & 2 Projektet e Vogla të Energjisë Hidroelektrike në Shqipëri, fq. 4 https://cdm.unfccc.int/Projects/Validation/DB/AJPEKEUWN3GZ9MOINEVTOA7AA3Y2IQ/view.html
28. https://ekolevizja.wordpress.com/2014/10/16/uji-i-librazhdit-keqperdoret-nga-hec-et-private/
29. Project Design Document (PDD) Rapuni 1 & 2 Projektet e Vogla të Energjisë Hidroelektrike në Shqipëri, fq. 4 https://cdm.unfccc.int/Projects/Validation/DB/AJPEKEUWN3GZ9MOINEVTOA7AA3Y2IQ/view.html
30. https://bankwatch.org/wp-content/uploads/2017/09/response-EBRD-RapuniTernoveAL-Aug2017.pdf

31. Korrespondencë me BERZH, 15 Nëntor 2017
32. https://bankwatch.org/wp-content/uploads/2017/09/response-EBRD-RapuniTernoveAL-Aug2017.pdf
33. http://www.qkr.gov.al/search/search-in-trade-register/search-for-subject/ aksesuar mw 23 Nwntor 2017)
34. http://www.qkr.gov.al/search/search-in-trade-register/search-for-subject/ aksesuar mw 23 Nwntor 2017)
35. Ibid.
36. Sipas pronarit ky mulli përdoret nga 200 familje të zonave përreth
37. Bisedë telefonike me Përparim Shkurtin, i biri i pronarit të mmullirit, 15 Nëntor 2017
38. https://web.archive.org/save/http://orthodoxalbania.org/alb/index.php/en-us/lajme-3/blog/4002-archbishop-anastasios-speech-at-the-ceremony-of-inauguration-of-rapuni-3-4-hydropower-station
39. Intervista në zonën e Togwz-it, 2 Qershor 2017; shiko edhe raportin e Bankwatch http://stories.bankwatch.org/going-through-the-mill
40. Intervistë me Arjan Cukaj, pronar i C & S Construction 5 Qershor 2017
41. Korrespondencë me BERZH, 15 Nëntor 2017
42. Shiko informacionin për kontratën http://www.opencorporates.al/en/nuis/K92402005Q; fakti që plani i Rapunit 3 & 4 ishte i ndryshëm në atë moment nuk e zhvleftëson nevojën për të vlerësuar ndikimet kumulative
43. http://business.financialpost.com/commodities/energy/quebec-entrepreneurs-bring-hydroelectric-expertise-to-the-balkans
44. https://web.archive.org/web/20171117083345/http://ice.al/detailed-design-of-hydropower-of-ternova/
45. https://bankwatch.org/wp-content/uploads/2017/09/response-EBRD-RapuniTernoveAL-Aug2017.pdf
46. VENDIM Nr. 676, datë 20.12.2002 PËR SHPALLJEN ZONË E MBROJTUR TË MONUMENTEVE TË NATYRËS SHQIPTARE http://extwprlegs1.fao.org/docs/texts/alb68750.doc see also http://eunis.eea.europa.eu/sites/182252; Ky pretendim është kontestuar nga BERZH, por pa burim për interpretim të ndryshëm
47. EBRD refuzoi të ndajë një hartë të projektit me Bankwatch (Korrespondencë me EBRD, 15 Nëntor 2017). Ne e bazojmë njohjen tonë mbi skemën e projektit në intervistat me aktorët lokalë dhe imazhet satelitore. Banorët vendas si dhe kompanitë e ndërtimit përdorin toponime të ndryshme për liqenet e lartpërmendura, gjë që çon në konfuzion të mëtejshëm.
48. Studim: Identifikimi i konflikteve të lidhura me ujin që kanë të bëjnë me projektet hidroenergjetike në Shqipëri, fq. 41 http://www.ecoalbania.org/wp-content/uploads/2017/04/Water_conflict_study-2017-1.pdf
49. Një punonjës i sektorit publik i cili dëshiron të mbetet anonim, na tregon për faktin se punimet filluan pa lejen e duhur. Raportet e medias rreth protestave gjithashtu tregojnë mungesën e lejeve http://www.tvbulqiza.al/bulqize-devijimi-i-rrjedhes-se-liqenit-ne-martanesh-protestojne-banoret-videolajm/
50. Vizita në terren u organizua në bashkëpunim të ngushtë me EcoAlbania dhe partnerët lokalë
51. https://bankwatch.org/blog/from-enver-hoxha-to-the-ebrd-and-back-hydropower-in-albania
52. https://bankwatch.org/wp-content/uploads/2017/09/response-EBRD-RapuniTernoveAL-Aug2017.pdf
53. Intervista me punonjësit e Inspektoriatit të Pyjeve
54. Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve gjobiti kompaninë Teodori 2003 shpk me 26,865,148.4 Lek (203,523 EUR) në 2013. Zyra vendore e Inspektoriatit nuk e di statusin aktual të gjobës, por është informuar se kompania e ka ankimuar atë.
55. Mansourian, S., Rossi, M., & Vallauri, D. (2013). Ancient Forests in the Northern Mediterranean: Neglected High Conservation Value Areas. Marseille, WWF France https://www.researchgate.net/profile/Daniel_Vallauri/publication/270647800_Ancient_Forests_in_the_Northern_Mediterranean_Neglected_High_Conservation_Value_Areas/links/54b1ab510cf28ebe92e18f85.pdf (faqe 32)
56. Bego, F. (2005). On the status and distribution of the large carnivores (Mammalia: Carnivora: brown bear, wolf and lynx) in Albania. Albanian J. Nat. Tech. Sci, 1, 41-53.
57. Shiko: Niketić, M., Cikovac, P., Barina, Z., Pifkó, D., Melovski, L., Duraki, Š., & Tomović, G. (2015). Viola chelmea and Viola jooi (Violaceae), new species for the flora of Serbia and their distribution in the Balkan Peninsula and the Carpathians. Bulletin of the Natural History Museum, (8), 49-74. and Barina, Z., Pifkó, D., Rakaj, M., & Barabás, S. (2015). Taxonomy of Scilla albanica Turrill (Asparagaceae). Folia Geobotanica, 50(2), 151-159.
58. Korrespondencë me BERZH, 15 Nëntor 2017
59. Bankwatch nuk ka pasur qasje në dokumentacionin e projektit, por kjo rrjedh nga fakti se projekti po sjell edhe ujë shtesë nga liqenet e tjera, që do të thotë se nuk ka ujë të mjaftueshëm për projektin vetëm nga ky liqen. Nuk është e qartë nëse rezervuari artificial është planifikuar përpara hidrocentralit, por është ndërtuar të paktën pjesërisht me një përfshirje të kompanisë së projektit.
60. Takim midis Bankwatch dhe stafit të BERZH Londër, 26 Janar 2016
61. Bisedë telefonike me një anëtar të komunitetit që dëshiron të mbetet anonim, Shtator 2017
62. Bujar Karoshi, Liqeni i Zi “nxin” mbi të ardhmen e Zerqanit! (in Albanian) http://www.rrugaearberit.com/arkiva/2014/gusht2014.pdf
63. Korrespondencë me BERZH-in, 15 Nëntor 2017